



VENDIM

Nr.101 Datë 07.12.2010

PËR

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË LIÇENSUARIT PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET E RINJ ME
FUQI TË INSTALUAR DERI NË 15 MW PËR PERIUDHËN 1 JANAR -
31 DHJETOR 2011**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Minsitrave Nr. 87, datë 16.01.2008 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.27 date 19.01.2007”, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncensioneve” , neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.24, datë 11.04.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2010, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e cmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për periudhën 1 Janar- 31 Dhjetor 2011,

Vendosi :

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2011 do të jetë 6.89 leke/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licensuarve dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.